Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

01 05-5697
-2- 13/08/2026
Prishtinë / a

Nr. 133/VIII/2026
Datë: 13/08/2026

Zëvendës Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në Nenin 7, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 08/L-220 Për çmimin e produkteve medicinale, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shpallet afati për paraqitjen e aplikimeve për ndryshimin e çmimit të produkteve medicinale nga bartësit e autorizimit për marketing ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, **nga data 17 gusht 2026 deri më 21 gusht 2026**, përmes sistemit elektronik "Barnatari", për produktet medicinale çmimet e të cilave janë përcaktuar dhe janë në fuqi gjatë vitit 2026.

2. Obligohet Komisioni per përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale për zbatimin e këtij vendimi dhe të përcaktojë çmimin e produkteve medicinale në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

3. Shtojca 1 është pjesë e këtij vendimi.

4.Vendimi hyn në fuqi me datë 17 gusht 2026.

Dr. Arsim Berisha
Zëvendës Ministër i Shëndetësisë

Vendimi i dërgohet:
- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Z. Edon Muçaj – Kryesues i Komisionit*
- *AKPPM;*
- *Divizionit të Farmacisë;*
- *Arkivit të MSH-së.*

SHTOJCA I

1.Bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesi me autorizim të bartësit të autorizim marketingut (në tekstin e mëtejmë aplikuesi) për ndryshim të çmimit të produketeve medicinale mund të aplikojë së bashku me dokumentacionin përcjellës si në vijim:

1.1.1 Letër përcjellëse nga BAM (Company Cover Letter).
1.1.2 Autorizimi për deklarimin e çmimit nga Bartësi i AM-së për aplikuesin (për përfaqësuesin);
1.1.3 Çertifikata e Autorizimit për Marketing (ku është e aplikueshme);
1.1.4 Dëshmi mbi çmimin e importit;
1.1.5 Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinator;
1.1.6 Deklaratë autentike e detajuar nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për arsyeshmërinë e ndryshimit të çmimit të produktit medicinal.